

Nr. 531
17.03.2025



K. Koshinjo
17.03.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 213/ prot.

Gjirokastrë, më 13.03.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 13, datë 27.2.2025 "Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2024", konfirmohet.
2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 14, datë 27.2.2025 "Për detajimin e plan-buxhetit për të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 dhe disa ndryshime në vendimin e këshilli të bashkisë nr. 72, datë 27.11.2024, 'Për miratimin e buxhetit të viti 2025", konfirmohet.
3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 15, datë 27.2.2025 "Heqje nga inventari i fondit kullosor në pronësi të Bashkisë Tepelenë", është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e Prefektit të qarkut.
4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 16, datë 27.2.2025 "Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr. 87/25, ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë", është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e Prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Odise Kote

